



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

1118/20  
28.01.2021  
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH .nr.1118/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paçarizi – Kryetar, z. Blerim Dina- Referues, dhe z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE NT “BITI-COM” - Podujevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë: OE NTSH “LULISHTJA BUÇAJ” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me Lule dhe Drunjë Dekorativ”, me numër të prokurimit: 616-20-1766-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, me datën 22.01.2021, mori këtë:

## V E N D I M

I. **HEDHET**, si e pa lejuar ankesa e operatorit OE NT “BITI-COM” – Podujevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ,për aktivitetin e prokurimit me titull : “Furnizim me Lule dhe Drunjë Dekorativ”, me numër të prokurimit: 616-20-1766-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull : “Furnizim me Lule dhe Drunjë Dekorativ”, me numër të prokurimit: 616-20-1766-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NT “BITI-COM” - Podujevë hedhet si e pa lejuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE NT "BITI-COM" - Podujevë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.12.2021, me nr. 1118/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull : "Furnizim me Lule dhe Drunjë Dekorativ", me numër të prokurimit: 616-20-1766-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës,

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7 dhe 131 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe Vendimin 782/20, të dt:13.11.2020 të OSHP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 31.12.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

### Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit është:

	13.2	Shuma e Sigurimit të Tenderit është <b>4000</b> për periudhë valide prej <i>shëno kohëzgjatjen në ditë</i>
--	------	--

Ndërsa në dosjen e tenderit validiteti i ofertave është kërkuar 90 ditë, shihë më poshtë:

Periudha vlefshmërisë së tenderit	22.1	Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: <b>90 ditë</b>
-----------------------------------	------	---

Ndërsa në njoftimin për kontratë është kërkuar:



**IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:**

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit 4000

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muaj

**IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:**

Deri më: data:  ditët 90 apo muajt

Eksperti shqyrtues sqaron se me Vendimin PSH.nr.872/20, të dt:13.11.2020, Paneli shqyrtues e ka konstatuar se Sigurimi i tenderit i ofruar nga OE N.T “Biti – Com”, nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit, për më tepër referoju dëshmisë më poshtë:

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.T. “Biti-Com” – Podujevë që ka të bëjë me vlefshmërinë e sigurisë së tenderit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit është që shuma e sigurimit të tenderit të jetë 4,000.00 euro, validiteti i ofertave 90 ditë, kurse në njoftimin për kontratë është kërkuar që periudha e vlefshmërisë së tenderit të jetë 90 ditë, vlera e sigurisë së tenderit 4,000.00 euro, si dhe vlefshmëria e sigurisë së tenderit të jetë 120 ditë. Lidhur me këtë kërkesë OE ankues N.T. “Biti-Com”, nuk e ka ofruar sigurimin prej 120 ditësh, por sigurimin e tenderit e ka ofruar nga Kompania e sigurimeve (SIGURI) për periudhë 90 ditë dhe në vlerë 4,000.00€. Pra, sigurimi i tenderit nuk është konform kërkesës. Për më tepër, në pjesën tabelore të nenit 39 të RRUOPP-së është përcaktuar që tenderi do të refuzohet kur sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e dosjes së tenderit.

Pra bazuar në Vendimin PSH.nr. 872/20, të dt:13.11.2020, dhe në dispozitat ligjore, konkretisht në paragrafin 1.26 të nenit 4 të LPP-së, OE ankues mund të konsiderohet edhe si palë pa interes, sepse është i papërgjegjshëm.

**Përgjigje në Pretendimi nr. 2**

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues NT “BITI-COM”, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP “LULISHTJA BUÇAJ”, menaxherin Leotrim (Naser) Krasniqi ( Bachelor i Agro Ekonomisë), nuk e ka ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku është kërkuar AGRONOM I DIPLOMUAR, si dhe si mund të lëshohet dy sqarime të ndjeshme nga i njëjti institucion. Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, është: “OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi). Në rast të grupit Menaxheri duhet të jetë pjesë e stafit të Liderit”. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emërton menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) ose marrëveshje paraprake për angazhim në projektin përkatës, me së paku 3 vite përvojë pune në OE e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin (e noterizuar), kontratën e punës, dëshmi mbi përvojën e punës nga ATK-ja, të jetë në listën e të punësuarve në

OE dhe të ofroj së paku 3 referenca për menaxhim të suksesshëm të projekteve të ngjashme në OE”.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP “LULISHTJA BUÇAJ”, në dosjen e tenderit e ka ofruar z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull “BACHELLOR I AGROEKONOMISË”, shih më poshtë



Në raportin e ekspertizës me Nr.517/20, kamë sqaruar se Kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është “Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi)”, ndërsa në Diplomë shënon “BACHELOR I AGRO EKONOMI”, si dhe duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe dëshminë e ofruar, kam sqaruar se konform nenit 59.2 të LPP-së, AK-së është dashur të kërkoj sqarime shtesë nga organi kompetent që e ka leshur diplomën, për gradën “BACHELOR I AGRO EKONOMI”. Në vendimin PSH. Nr.517/20, të dt:17.09.2020, Paneli ka konstatuar, shih më poshtë:

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues NT “BITI-COM”, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP “LULISHTJA BUÇAJ”, menaxherin Leotrim (Naser) Krasniqi, i cili është Bachelor i Agro Ekonomisë, nuk e ka ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku është kërkuar AGRONOM I DIPLOMUAR. Paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe të



njoftimit për kontratë është: “OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi). Në rast të grupit Menaxheri duhet të jetë pjesë e stafit të Liderit”. Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emërton menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) ose marrëveshje paraprake për angazhim në projektin përkatës, me së paku 3 vite përvojë pune në OE e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin (e noterizuar), kontratën e punës, dëshmi mbi përvojën e punës nga ATK-ja, të jetë në listën e të punësuarve në OE dhe të ofroj së paku 3 referenca për menaxhim të suksesshëm të projekteve të ngjashme në OE”.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar për këtë pikë nga OE i rekomanduar sqaron se i njëjti në dosjen e tenderit për kërkesën e cekur si më lartë, e ka ofruar z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull “BACHELLOR I AGROEKONOMISË”.

Kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është “Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi)”, ndërsa në Diplomë shënon “BACHELOR I AGRO EKONOMI”.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në kërkesën e AK-së dhe dokumentacionin e ofruar nga AK sqaron se AK gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit duhet të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59. 2 dhe 72 të LPP-së në mënyrë që të vërtetoj nga organi kompetent që ka lëshuar diplomën dhe të vërtetoj se a janë të barabarta gradat me sistemin e ri të studimeve, më saktësisht a janë të barazvlefshme grada “bachelor i Agroekonomisë” me “Agronom i diplomuar” dhe që AK të specifikoj çartë se a përputhet diploma e ofruar nga OE i rekomanduar me kërkesën e bërë nga ata.

Eksperti shqyrtues sqaron se me Vendimin PSH.nr.872/20, të dt:13.11.2020, Paneli shqyrtues e ka konstatuar:

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se AK nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, duke kërkuar nga organi kompetent nëse diploma në fjalë është në harmoni me kërkesën e AK-së.

Autoriteti kontraktues, sa i përketë menaxherit të projektit z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull “BACHELLOR I AGROEKONOMISË”, kërkon sqarime dhe vendimin e tyre e arsyetonë në këtë mënyrë, shihë dëshmitë:

Poashtu Autoriteti Kontraktues me date: 04.12.2020 i ka kërkuar sqarim OE te rekomanduar per dhënie te kontratës lidhur me sqarimin e titullit AGRONOM i DIPLOMUAR (drejtimi AGROEKONOMI) me c'rast OE i rekomanduar per dhënie te kontratës ka sjellur dëshmitë nga Organet Kompetente zyrtare sic janë: AGJENCIONI I KOSOVËS PËR AKREDITIM si dhe FAKULTETI I BUIQËSISË DHE VETERINARISË:



Lulishtja BUÇAJ <lulishtjabucaj@gmail.com>

## Kërkesë për sqarim

1 message

Lulishtja BUÇAJ <lulishtjabucaj@gmail.com>  
To: shkelzen.gerxhaliu@rks-gov.net

Fri, Nov 20, 2020 at 2:04 PM

Përsëritje e 1-ës.

Bashkangjitur me këtë email keni kërkesën për sqarim.  
Pres përgjigje nga ana juaj!

Me respekt,  
Leotrim Krasniqi

Menaxher/Agronom

N.T.P "LULISHTJA BUÇAJ"  
Nr.Tel: +383 45 50 44 00  
+383 48 50 44 00  
+383 45 69 69 69  
Web: [www.lulishtjabucaj.com](http://www.lulishtjabucaj.com)



### 2 attachments

- Kërkesë për sqarim.pdf  
316K
- Diploma Leotrim Krasniqi.pdf  
2000K

## Re: Kërkesë për sqarim

3 messages

**Shkelzen Gerxhaliu** <Shkelzen.Gerxhaliu@rks-gov.net>  
 To: Lulishtja BUÇAJ <lulishtjabucaj@gmail.com>

Fri, Nov 20, 2020 at 6:01 PM

Pershendetje i nderuar,

Ne baze te kerkese tuaj, Agjencia e Kosoves per Akreditim ju konfirmon se sipas Ligjit per Arsimin e Larte nr. 04/L-037 si dhe Kornizes Kombetare te Kualifikimeve, diploma e bashkangjitur eshte diplome e nivelit 6 (niveli Bachelor), dhe titulli i fituar ne baze te programit te studimit eshte Agronom.

Nese ju duhen sqarime shtese, ju lutem me kontaktoni.

Me respekt,

Von meinem iPhone gesendet

> Am 20/11/2020 um 14:05 schrieb Lulishtja BUÇAJ <lulishtjabucaj@gmail.com>:

>

> Përsëritje i nderuar,

>

>

> Bashkangjitur me këtë email keni kërkesën për sqarim.

> Pres përgjigje nga ana juaj!

>

>

> Me respekt,

> Leotrim Krasniqi

>

> Menaxher/Agronom

>

> N.T.P "LULISHTJA BUÇAJ"

> Nr.Tel: +383 45 50 44 00

> +383 48 50 44 00

> +383 45 69 69 69

> Web: www.lulishtjabucaj.com<<http://www.lulishtjabucaj.com>>

> [[https://docs.google.com/uc?export=download&id=1XCHG7KmhY1IVPWm7epCKQ0Ke5VoXl0m\\_&revid=0B6PykSoVwwNQckIRMHNCSXBhOFI5WE5mQys5aFRwWXR4enZrPQ](https://docs.google.com/uc?export=download&id=1XCHG7KmhY1IVPWm7epCKQ0Ke5VoXl0m_&revid=0B6PykSoVwwNQckIRMHNCSXBhOFI5WE5mQys5aFRwWXR4enZrPQ)]

Në bazë të nenit 100 pika 2 e 3 e Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në mbledhjen e mbajtur më 17.10.2008 nxori këtë

## **RREGULLORE PËR STUDIME THEMELORE – BACHELOR**

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1**

Me këtë Rregullore rregullohen këto çështje:

- Llojet e studimeve;
- Kushtet e regjistrimit në studime;
- Kohëzgjatja e studimeve;
- Statusi i studentit;
- Të drejtat dhe detyrimet e studentëve;
- Kushti i regjistrimit të vitit;
- Afatet, paraqitja dhe mënyrat e dhënies së provimeve;
- Përfundimi i studimeve dhe punimi i diplomës;
- Përgjegjësia disipline;
- Dispozitat kalimtare.

#### **1**

### **Llojet e studimeve**

#### **Neni 2**

Me qëllim të përgatitjes së kadrit për veprimtari profesionale dhe kërkimore-shkencore Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, organizon studime të rregullta, me vetfinansim (që nuk financohen nga fondet publike), dhe studime me korrespondencë.

#### **Neni 3**

Studimet në Departamentin e Veterinarisë, organizohen vetëm të rregullta dhe kohëzgjatja e tyre është pesë vite.

#### **Neni 4**

Studimet themelore-Bachelor organizohen në këto Departamente:

1. Agroekonomi
2. Blegtori
3. Lavertari-Perituri
4. Mbrojtje të bimëve,
5. Penetari-Vrshitari

#### **Neni 5**

Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teknike, ushtrimeve në laborator, punës praktike në terren, ekskursioneve shkencore-mesimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmjet punimeve të pavarura të studentëve.

#### **Neni 6**

Studimet me korrespondencë mund të vjohën, pa shëqerje dhe me shëqerje nga puna, kombinimi i këtyre mënyrave të studimit, ashtu siç parashihet me Ligjin e Arsimit të Lartë të Kosovës dhe me Statut të Universitetit të Prishtinës.



#### Neni 41

Për hartimin e punimit të diplomës është paraprirë afat prej së paku 3 e më së shumti 12 muaj nga dita e zyrtarizimit. Në rastet e arsyeshme ky afat mundë të zgjatet edhe për dy muaj. Kërkesën për zgjatjen e afatit të përfundimit të temës së diplomës me arsyetimin përkatës e bën studenti, ndërsa vendimin për aprovim e marr Dekani i Fakultetit.

#### Neni 42

Në fillim të çdo viti të ri akademik Departamentet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë i paraqesin propozimet e temave të punimit të diplomave.

Propozimi i temave të punimit të diplomave bëhet nga secili mësimdhënës në departamentin e caktuar. Mësimdhënësi që ka propozuar temën e punimit të diplomës e udhëhoq studentin në rolin e mentorit deri në përfundim të punimit të diplomës.

Brenda një viti akademik, mësimdhënësi nuk mund të ngarkohet me më shumë se 5 punime të diplomës, për rastet të jashtëzakonshme (në numëresë të mësimdhënësve në Departament) ky numër mund të shtohet me Vendim të Dekanit.

#### Neni 43

Punimin e diplomës studenti e dorëzon në pesë ekzemplare së paku 7 ditë para mbrojtjes, në shërbim të studenteve. Dekani e lejon mbrojtjen e caktion komisionin dhe datën e mbrojtjes.

Nëse punimi vlerësohet pozitivisht, shkruhet raporti në procesverbal të mbrojtjes nga anëtarët e komisionit.

#### Neni 44

Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe zhvillohet para Komisionit të përbërë nga tre anëtarë (mentorit dhe dy anëtarëve të lënë të ngushtë me temën) të propozuar nga mentorit i punimit të temës, që miratohet nga Dekani i Fakultetit.

Gjatë mbrojtjes me gojë të punimit të diplomës nga ana e kandidatit, komisioni miratë procesverbalin.

Komisioni e vlerëson punimin e diplomës në pajtim me kriteret e përcaktuara dhe vlerësimin me notë e shënon në Procesverbal dhe Indeks.

#### Neni 45

Kandidati i cili punimin e diplomës nuk e ka dorëzuar në afatit e zgjatur, punimi i diplomës me shkurt dhe gojë nuk ka qenë e suksesshme i caktohet punimi i ri i diplomës.

#### Neni 46

Studenti i cili përfundon me sukses studimet Bachelor fiton titullin akademik Bachelor i Shkencave Bujqësore për Drejtimin përkatës.

Diplomën për kryerjen e studimeve Bachelor e nënshkruan Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit. Përmbajtjen dhe formën e diplomës e përcakton MASHT-i.

### IX

#### Përgjegjësi disiplinore

#### Neni 47

Studentët që i shkelin rëndë rregullat, mundë të përjashtohen përgjithmonë ose përkohësisht nga Universiteti-Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Studentët e dënuar për shkelje kanë të drejtë të ankohen Këshillit të Fakultetit.

Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Senatit të Universitetit, i cili mundë të konfirmoj ose të zhvlerësoj vendimin e Këshillit të Fakultetit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin të intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Me respekt,

**Departamenti i Prokurimit**



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosovo za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency




Dt. 25.11.2020 Ref: 2954/20

**Konfirmim**

Në bazë të kërkesës së Leotrim (Naser) Krasniqi, Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), konfirmon se programi i studimit Agroekonomi / BSc, i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" i është nënshtruar procesit të akreditimit, dhe kërkesa e tyre për akreditim është miratuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), me vendim të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) vendimi Nr.403/10 datë 09.06.2010.

Po ashtu ju konfirmojmë se titulli i të lartpërmendurit është Agroekonomist i diplomuar në përputhje me Komizin Kombëtare të Kualifikimeve 6, BSc 180 ECTS.

Besim Jonuzaj,  
Zyrtar i Personelit  
Agjencia e Kosovës për Akreditim



### SQARIM

N.T.P. "Lulishtja Buçaj" me NUI: 810718075 me seli në Gushtericë të Ulët – Graçanicë, e përfaqësuar nga Pleurat Buçaj, Sqaron për autoritetin kontraktues se titulli i fituar BACHELOR I AGROEKONOMISE I Menagjerit të projektit Z.Leotrim Krasniqi për titull: "Furnizim me lule dhe drunjë dekorativ" me numër të prokurimit: 616-20-1766-1-1-1 dhe numër të brendshëm: 616 20 048 111 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Ku si dëshmi për titullin e fituar ju bashkangjitur kemi Diploma ,emalin si dhe sqarimin nga Agjensioni për akreditim të Kosovës

Gushtericë e Ulët - Graçanicë

05.12.2020

N.T.P. "Lulishtja Buçaj"



Andaj duke pasur parasysh vendimin PSH. Nr. 872/20, të dt:13.012.2020, eksperti shqyrtues sqaron se AK-së, ka vepruar konform vendimit PSH. Nr. 872/20, të dt:13.012.2020, ku është kërkuar që konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, AK-së të kërkojë sqarime shitesë se Diploma në fjalë a është në harmoni me kërkesën e dosjes së tenderit. Pra siç shihet në sqarimin përmes e-mailit të dt:20.11.2020 dhe Konfirmimit me nr. Protkoli 2954/20, të dt:25.11.2020, Agjencia e Kosovës për Akreditim, deklaroi se titulli i të lartpërmendurit është Agroekonomist i diplomuar në përputhje me Kornizën Kombëtare të kualifikimeve 6, BSc 180 ETCTS. Pra bazuar në sqarimet të cilat janë të ofruara si dëshmi më lartë, mendoj se përgjegjësia bije mbi organin të cilin e ka dhanë në konfirmimin e prezantuar, si dhe në përgjegjësin e AK-së.

### Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues NT "BITI-COM", pretendon se Certifikatat e origjinës së mallit Itali, ofruara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP "LULISHTJA BUÇAJ", janë të dyshimta



(të falsifikuara). Sa i përket pretendimeve në lidhje me Certifikatat dhe Licencat e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, ku OE ankues NT "BITI-COM", pretendon se janë të falsifikuara, eksperti shqyrtues sqaron se në vendimin PSH. Nr. 872/20, të dt:13.012.2020, është thënë, shih dëshminë

Në lidhje me pretendimin tjetër të OE ankues NT "BITI-COM", se certifikatat e origjinës së mallit Itali të ofruara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ", janë të dyshimta (të falsifikuara).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kjo çështje është përgjegjësi e organeve përgjegjëse që merren me këto punë, nuk është përgjegjësi dhe kompetencë e OSHP-së që të vërtetoj nëse janë të falsifikuara sepse nuk kemi mekanizmat e nevojshme për tu marrë me vërtetësinë e këtyre dokumenteve mirëpo këto pretendime duhet ti vërtetoj AK gjate rivleresimit.

Si dëshmi për Certifikatat janë ofruar këto, ku janë bashkangjitur edhe në Vendimin e AK-së, shih dëshmitë:

<b>1. Expeditor - Esporteur - Exporteur</b> <b>AZIENDA AGRICOLA</b> <b>GOCAJ ALMA</b> Via D'Angelo Arlino, 70 51100 PISTOIA (PT) CF e iscr. R.I. G01647704100H P.I. 01810540471 Codice R.U.P. PT/0945390 Cell. 347/1297105		<b>Z / 0795637</b>	<b>ORIGINALE</b>
<b>2. Destinataria - Destinataire - Consignee - Destinatario</b> <b>LULISHTJA BUÇAJ</b> <b>URBAN REISMAN</b> <b>KOSOVO</b>		<b>UNIONE EUROPEA</b> <b>UNION EUROPÉENNE</b> <b>UNIÓN EUROPEA</b> <b>CERTIFICATO DI ORIGINE</b> <b>CERTIFICAT D'ORIGINE</b> <b>CERTIFICATE OF ORIGIN</b> <b>CERTIFICADO DE ORIGEN</b>	
<b>3. Paese d'origine - Pays d'origine - Country of origin - País de origen</b> <b>ITALIA</b>		<b>4. Osservazioni - Remarques - Remarks - Observaciones</b> PL n° 6408 23/02/19 PL SA 03 01/03/19 PL n° SA 03 01/03/20 PL SA 03 01/03/20 PL n° 408 01/03/20 PL 13 03 01/03/19 PL n° 16 01 01/03/20 PL n° 16 01 01/03/20 PL 12 01 23/04/20	
<b>5. N. d'ordine, marche, numéri, quantité e natura dei colli; désignations des marchandises</b> <b>Item number, marks, numbers, number and kind of packages, designation of goods</b> <b>Nº de orden, marcas, números, número y naturaleza de los bultos; designación de las mercancías</b> LIUSTICH VARNICA 1340 PICEA IN VASETA 143 ALCE IN VASETA 323 LAGESTOCHIA 141 CUPRESSUS 350 HIBISCUS 90 ILIEX 160 FESICLA GLAUC 170 ABIES 240 BUXUS 420 PINUS INVAR 460 TILIA 520 CUP VENTILANDI 350 PLATANUS 1200 CATALPA 200 MAGNOLIA 160 ALIOTINIA E ROBIN 220 SAUX 20 PINUS 60 JUNIPERUS 150 CEDRUS 170 CORYMBUS 50 ACADIA 100 CAMELIA 50 CAMERIA 50 TAMUS 50 BAMBUSA 50 OLIVAEOLUS 50 EUONYMUS 50 ROSE 50 LIQUIDAMBAR 150 SILENE 50 BETULA 70 BERBERIS 70 TRINA 100 FRUIT RUX 100 LAURO 50 LIQUIDAMBAR 50		<b>6. La sottoscritta autorità certifica che le merci sopra elencate sono originarie del paese menzionato nel riquadro 3</b> <b>L'Autorité soussignée certifie que les marchandises désignées ci-dessus sont originaires du pays figurant dans le case N° 3</b> <b>La Autoridad infrascrita certifica que las mercancías designadas son originarias del país indicado en la casilla N° 3</b> <b>AZIENDA AGRICOLA</b> <b>GOCAJ ALMA</b> Via D'Angelo Arlino, 70 51100 PISTOIA (PT) CF e iscr. R.I. G01647704100H P.I. 01810540471 Codice R.U.P. PT/0945390 Cell. 347/1297105	

AZIENDA AGRICOLA  
GOCAL ALMA  
Via D'Angela, 28 51100 - Pistoia (PT)  
C.F. e Iscr. GOCALMA77C647100M  
P.IVA 01810360477

PISTOIA, 25/11/2020

OGGETTO: INVIO CERTIFICATO DI ORIGINE.

Con la presente siamo ad inviarvi il certificato di origine, relativo alle piante spedite e che ritrovate nelle seguenti fatture:

FT. N° 4/A DEL 25/02/2019  
FT. N° 5/A DEL 02/03/2019  
FT. N° 5/A DEL 04/03/2020  
FT. N° 9/A DEL 04/03/2020  
FT. N° 10/A DEL 07/03/2020  
FT. N° 13/A DEL 08/04/2019  
FT. N° 14/A DEL 08/04/2020  
FT. N° 16/A DEL 24/04/2020  
FT. N° 17/A DEL 25/04/2020.

CORDIALI SALUTI  
GOCAL ALMA

AZIENDA AGRICOLA  
GOCAL ALMA  
Via D'Angela, 28 51100 PISTOIA (PT)  
C.F. e Iscr. GOCALMA77C647100M  
Codice Fiscale 01810360477  
Tel. 0573/2297102

Për validitetin e këtyre dëshmime mbanë përgjegjësi AK-ja dhe OE i cili i ka ofruar si dëshmi këto dokumente.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datën 07.01.2021 me anë të parashtresës, e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/profesional, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.



Paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit është: "shuma e sigurimit të tenderit është 4000 për periudhë valide prej *shëno kohëzgjatjen në ditë*", ndërsa në dosjen e tenderit validiteti i ofertave është kërkuar 90 ditë, ndërkaq në njoftimin për kontratë është kërkuar: "vlera e sigurisë së tenderit: 4000, vlefshmëria e sigurisë së tenderit 120 apo muaj"

Në vendimin PSH.nr.872/20, të dt:13.11.2020, Paneli shqyrtues e ka konstatuar se Sigurimi i tenderit i ofruar nga OE N.T "Biti – Com", nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit, andaj duke u bazuar në vendimin e lartcekur, duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura, rezulton se operatori ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit është palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë se shkelja e supozuar i është kërcënuar ti shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, i njëjti operator në asnjë variant nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues NT "BITI-COM", pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP "LULISHTJA BUÇAJ", menaxherin Leotrim (Naser) Krasniqi (Bachelor i Agro Ekonomisë), nuk e ka ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku është kërkuar AGRONOM I DIPLOMUAR, si dhe si mund të lëshohet dy sqarime të ndjeshme nga i njëjti institucion. Paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, është: "OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi). Në rast të grupit Menaxheri duhet të jetë pjesë e stafit të Liderit". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emërton menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) ose marrëveshje paraprake për angazhim në projektin përkatës, me së paku 3 vite përvojë pune në OE e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin (e noterizuar), kontratën e punës, dëshmi mbi përvojën e punës nga ATK-ja, të jetë në listën e të punësuarve në OE dhe të ofroj së paku 3 referenca për menaxhim të suksesshëm të projekteve të ngjashme në OE".

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP "LULISHTJA BUÇAJ", në dosjen e tenderit e ka ofruar z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull "BACHELLOR I AGROEKONOMISË".

Autoriteti kontraktues, sa i përket menaxherit të projektit z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull "BACHELLOR I AGROEKONOMISË", ka kërkuar sqarime nga OE të cilët kanë sjellur dëshmi nga Agjencioni i Kosovës për akreditim si dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë ku në sqarimin përmes e-mailit të dt:20.11.2020 dhe Konfirmimit me nr. Protkoli 2954/20, të dt:25.11.2020, Agjencia e Kosovës për Akreditim, deklaroi se titulli i të lartpërmendurit është Agroekonomist i diplomuar në përputhje me Kornizën Kombëtare të kualifikimeve 6, BSc 180 ETCTS. Andaj nga sqarimet të cilat janë të ofruara si



dëshmi më lartë, paneli shqyrtues vlerëson se përgjegjësia bije mbi organin të cilin e ka dhanë në konfirmimin e prezantuar, si dhe në përgjegjësinë e AK-së.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues NT "BITI-COM", pretendon se Certifikatat e origjinës së mallit Itali, ofruara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP "LULISHTJA BUÇAJ", janë të dyshimta (të falsifikuara). Sa i përket pretendimeve në lidhje me Certifikatat dhe Licencat e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, ku OE ankues NT "BITI-COM", pretendon se janë të falsifikuara. Si dëshmi për Certifikatat nga AK janë ofruar si më lartë.

Paneli shqyrtues sqaron se është përgjegjësi e AK-së sa i përket vërtetësisë së këtyre dokumenteve dhe se paneli shqyrtues nuk është mekanizëm që të bëjë verifikimin e tyre.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e dhëna si më lartë dhe dëshmitë e ofruara nga AK sa i përket procesit të rivlerësimit, paneli shqyrtues vlerëson se rivlerësimi është bërë konform nenit 72 të LPP-së si dhe ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK – Komuna e Prishtinës
- 1x1 OE ankues – NT "BITI-COM" - Podujevë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Nuhi Paçarizi